



PLANI 10 DITOR

“Ditët më të vlefshme të dynjasë
janë dhjetë ditët (e Dhul-
hixhes).”



MUHAMED HUSEJN JAKUB

Plani dhjetëditor

﴿مشاريع العشر﴾

[Shqip – Albanian – ألباني]

Muhamed Husejn Jakub

Përktheu: Ulvi Fejzullahu

Redaktoi: Redaksia e albislam.com

2010 - 1431

islamhouse.com

﴿مشاريع العشر﴾ « باللغة الألبانية »

محمد حسين يعقوب

ترجمة: دريتون ليكاي

مراجعة: هيئة تحرير موقع ألب إسلام

2010 - 1431

islamhouse.com

Me të vërtetë, lavdërimi i takon vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë e falje kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të keqes së vetvetes (shpirtrave) tonë dhe prej punëve tona të liga. Atë të cilin Allahu e udhëzon, nuk ka se kush ta humbë, dhe atë të cilin Allahu e ka lënë në humbje nuk ka se kush ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër (me të drejtë) përveç Allahut, të Vetëm e të Pashoq, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Allahut. Paqja e Allahut qoftë mbi të, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij me sinqeritet deri në Ditën e Gjykimit, dhe Allahu i bekoftë të gjithë ata me shumë bekime.

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Ali Imranë 102)

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkon të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.” (Ennisa,1)

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.” (Ahzabë, 70-71)

Vëlla i dashur!

Eja me mua të të dhuroj një plan të pasur.

Fillimisht, së bashku me mua përsërit fjalën e të dashurit tënd, Muhamedit salallahu alejhi ve selem: *“O Zoti im, kërkoj mbrojtjen Tënde nga brenga dhe hidhërimi, nga paaftësia dhe dembelizmi, nga koprracia dhe frika si dhe nga zhytja në borxhe dhe nga epërsia e njerëzve!”* (Shënon Buhariu)

Vëlla i dashur, a nuk erdhi koha të largohesh nga brengat dhe hidhërimet e dynjasë?!

Vëlla i dashur, a nuk ka ardhur momenti ta largosh nga trupi paaftësinë dhe dembelinë?!

Vëlla i dashur, a nuk erdhi koha ta pastrosh zemrën nga koprracia dhe frika?!

Vëlla i dashur, a nuk ka ardhur koha ta paguash borxhin dhe ta kryesh hakun tënd ndaj Allahut, i Cili të ka dhuruar dhunti dhe të mira të panumërta?!

Allahu i Lartësuar thotë: *“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen?”* (Hadidë: 16)

“Dijeni, se Allahu e ngjall tokën pas vdekjes së saj. Ne ju sqarojmë shpalljet, në mënyrë që ju të kuptoni!” (Hadidë: 17)

Vlera e dhjetëditëshit të Dhul-hixhes

Vëllezërit e mi!

Vërtet ju dua për hir të Allahut të Lartësuar dhe e lus Allahun të na mbledhë me këtë dashuri nën hijen e Arshit të Tij, pasi nuk ekziston hije tjetër pos saj!

Allahu im, bëji veprat tona të gjitha të mira, bëji ato të sinqerta vetëm për Ty!

Mëso, vëlla i dashur, se Allahu i Lartësuar e ka zgjedhur kohën. Pjesa më e dashur për Allahun janë muajt e shenjtë, ndërsa prej muajve të shenjtë më i dashuri është Dhul-hixheja, kurse prej këtij muaji më të dashura janë dhjetë ditët e para të tij.

Ky dhjetëditësh nuk është si një dhjetëshe e zakonshme, por përfshin dhe përmbledh në vetvete dhjetë merita dhe cilësi të larta.

E para: Allahu i Lartësuar betohet për dhjetëshen e këtij muaji dhe thotë: *“Betohem për muzgun e agimit dhe për dhjetë netët (e para të muajit Dhul-hixhe)! Betohem për çiftin dhe tekun dhe për natën kur largohet! A nuk janë këto betime të mëdha për njerëzit e mençur?!”* (Fexhër, 1-5)

E dyta: Këto ditë i ka quajtur *“ditët e caktuara”* duke thënë: *“...dhe të përmendin emrin e Allahut në ditët e caktuara.”* (Haxh: 28)

E treta: Muhamedi salallahu alejhi ve selem dëshmoi për to se janë ditët më me vlerë të dynjasë. Xhabiri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “Ka thënë i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem: *“Ditët më të vlefshme të dynjasë janë dhjetë ditët (e Dhul-hixhes).”* (Sahihul-xhami”, Albani e vlerëson të saktë)

Gjithashtu, Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Nuk ka ditë që vepra të jetë më madhështore dhe më e dashur tek Allahu sesa këto dhjetë ditë, prandaj shqiptoni sa më shumë tehlil (La ilahe il-lAllah), tekbir (Allahu ekber) dhe tahmid (El-hamdu lil-lah).”* (Shënon Ahmedi)

E katërta: Muhamedi salallahu alejhi ve selem porositi për veprime të hajrit në këto ditë.

E pesta: Muhamedi salallahu alejhi ve selem urdhëroi që në këto ditë të madhërohet Allahu dhe të falënderohet.

E gjashta: Në këto ditë gjendet dita e tervijes.

E shtata: Gjatë këtyre ditëve është edhe dita e Arafatit, agjërimi i së cilës fshin gjynahet e dy viteve.

E teta: Të mirat e këtyre ditëve shumëfishohen. Disa prej selefiteve kanë thënë: “Nuk ka ditë më të dashura për Allahun sesa adhurimi (ibadeti) për Të gjatë këtyre dhjetë ditëve të Dhul-hixhes, kur çdo ditë është e barabartë me një vit agjërim, falja për çdo natë e namazit të natës është si namazi në Natën e Kadrit.”

Ibni Abbasi, Allahu qoftë i kënaqur më të, ka thënë: “Nuk ka ditë që vepra të jetë më e dashur për Allahun sesa këto dhjetë ditë, prandaj shpreshtoni sa më shumë “La ilahe il-lAllah”, “Allahu ekber” dhe “El-hamdu lil-lah”. Një ditë agjërimi në këto dhjetë ditë është e barabartë me një vit agjërimit dhe veprat në këto ditë shumëfishohen deri në shtatëqind fish.”

Enes bin Maliku, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: *“Për dhjetëshen e Dhul-hixhes është thënë se çdo ditë ka vlerën e një mijë ditëve, dita e Arafatit të dhjetë mijë ditëve.”* (Shënon Bejhekiu, Asfahaniu, Mundhiriu dhe thotë se isnadi i Bejhekiut bën.)

Imam Evzaiu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Më ka ardhur lajmi se puna në njërin prej dhjetë ditëve është si vlera e luftës në rrugën e Allahut, kur agjërimi bëhet ditën e roja natën.”

Hasan el-Basriu ka thënë: “Agjërimi i një dite nga kjo dhjetëshe barazohet me dy muaj.”

E nënta: Në këtë dhjetëshe është haxhi.

E dhjeta: Është dita e Bajramit, ndër ditët më me vlerë. Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Dita më e vlefshme tek Allahu është dita e Bajramit e pastaj dita që vjen pas saj.”* (Shënon Ebu Davudi, Albani e vlerëson sahih.)

Kujdes vëlla sepse pa dyshim që këto dhjetë ditë janë një mundësi e madhe në jetën tënde, një faqe e re në

raportin tënd me Allahun. Këto janë ditët më të mira të Allahut.

Mendo që këto ditë janë më të vlefshme se dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem thotë: *“Nuk ka ditë në të cilat vepra e mirë është më e dashur për Allahun sesa në këtë ditë (të Dhul-hixhes).”* I thanë: “As xhihadi?” Tha: *“As xhihadi, përveç nëse del dikush vetë dhe me pasurinë e vet dhe nuk kthehet me asgjë.”* (Shënon Buhariu)

Shikoni se si shprehën habi sahabët, saqë thanë: *“As xhihadi?”* Sepse xhihadi është shkalla më e lartë e Islamit.

Shiko, vëlla i dashur, se si kjo dhjetëshe ka arritur shkallën më të lartë. Dobia tjetër që të njeh me një vlerë tjetër të kësaj dhjetëshe është fjala e Allahut të Lartësuar:

“Ne i premtuam Musait se do t’i flisnim pas tridhjetë netësh, të cilat ia shtuam edhe me dhjetë të tjera, kështu që takimi me Zotin e tij u bë pas dyzet netësh.” (Araf, 142)

Disa studiues të tefsirit kanë thënë se “dhjetë të tjera” janë dhjetëshja e Dhul-hixhes.

Shiko se si Allahu i dhuroi mirësi Musait alejhis selam dhe të Dërguarit tonë, Muhamedit sal-lallahu alejhi ve selem, duke i shpallur atij se pas tridhjetë netëve u desh të plotësohen edhe dhjetë ditë të Dhul-hixhes.

Muxhahidi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Nuk ka vepër që gjatë ditëve të vitit është më e mirë sesa në dhjetëshen e Dhul-hixhes.”

Allahu i Lartësuar e nderoi Muhamedin salallahu alejhi ve selem dhe umetin e tij duke u dhënë çdo vit nga tridhjetë net të bekuara, që janë ato të Ramazanit. Këtë vlerë shtesë e plotësoi edhe me dhjetë ditët e Dhul-hixhes.

Pa dyshim që ky është një rast i volitshëm për të filluar një faqe të re me Allahun e Lartësuar, shans për të fituar sevape të pakufishme. Është shansi për të fituar të mira që janë më të vlefshme se të shpenzuarit e pasurisë, jetës dhe shpirtit në xhihad.

Ky është shansi për ripërtëritjen dhe rimbushjen e zemrës tënde.

Ibni Rexhepi thotë: “ Çdo njeri nuk e ka mundësinë e vizitës së Qabes çdo vit, ndërsa haxhi është detyrim një herë në jetë për atë që ka mundësi. Kështu që këtë dhjetëshen e ka bërë që të jenë pjesëmarrës, pra të jenë të njëjtë si pjesëmarrësit në haxh ashtu edhe jopjesëmarrësit. Kush nuk mund të shkojë në haxh këtë vit, i vlerësohet vepra e tij në shtëpi këto dhjetë ditë si më të vlefshme se xhihadi, që është më i vlefshëm se haxhi.”

Ditët e para të Dhul-hixhes janë ditët për të cilat Allahu i Lartësuar betohet. Betimi fillon me agimin duke thënë: *“Betohem për muzgun e agimit dhe për dhjetë netët”*, që këto ditë të jenë agim i ri në jetën tënde.

Atëherë, pas gjithë kësaj që u tha, patjetër që duhet të kesh një plan të qartë dhe të menduar mirë, që në fund të dhjetë ditëve të jesh fitues. Largoje përtesën dhe dembelinë dhe cakto qëllimin tënd. Atëherë projektet në vijim të jenë jo vetëm propozim, por detyrim. Realizoji të gjitha, të paktën një herë në jetë.

1. Projekti i Kuranit

Allahu i Lartësuar thotë: *“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.”* (Israë: 82)

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Kush lexon një shkronjë nga libri i Allahut ka nga një shpërblim, kurse çdo shpërblim dhjetëfishohet. Nuk them se ‘eliflammimi’ është një shkronjë, por elifi është një shkronjë, lami është një shkronjë dhe mimi është një shkronjë.”* (Shënon Tirmidhiu, Albani *shpjëson sahih.*)

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Përkujtoje Allahun, lexoje Kuranin që është shpirti juaj në qiell, dhe përkujtimi i juaji në tokë.”* (Shënon Ahmadi, Albani *shpjëson sahih.*)

Vëlla i dashur, patjetër bëje të paktën një hatme Kurani gjatë këtyre dhjetë ditëve dhe gjatë leximit të Kuranit zbriti ajetet e tij në zemër si shërim. Kërko shërimin e zemrës tënde në Kuran. Analizo çdo ajet, mendo për çdo fjalë e çdo germë.

Është pyetur Esmaja, e bija e Ebu Bekrit, si ishin shokët e Muhamedit salallahu alejhi ve selem kur e dëgjonin Kuranin? Ajo tha: “Sytë e tyre lotonin dhe lëkurat u dridheshin.” Allahu i Lartësuar thotë: *“Allahu ka shpallur fjalën më të bukur (Kuranin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrëqethet lëkura atyre që i frikësohen Zotit të tyre e, mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu. Ky libër është udhëzim i Allahut. Nëpërmjet tij Allahu udhëzon kë të*

dojë. Ndërsa atë që Allahu e shpie në humbje, s'mund ta udhëzojë kush.” (Zumr: 23)

Për ta bërë hatme Kuranin gjatë dhjetë ditëve lexo nga tre xhuze çdo ditë.

Po të jesh gati, të përgëzoj.

Tre xhuze, duke i llogaritur me nga dhjetë sevape (shpërblime), bëjnë gjysmë milioni shpërblime.

Urdhëro dhe shpejto. Gjysmë milioni të mira, fitim i pastër ditor vetëm prej Kuranit.

Pastaj surpriza tjetër: gjatë këtyre ditëve të bekuara të mirat shumëfishohen, kështu që një milion bëhet miliona.

Kurani të ofron miliona shpërblime, prandaj le të fillojmë t'i marrim.

2. Projekti i banketit për çdo namaz

Muhamedi salallahu alejhi ve selem ka thënë: *“Kush shkon në xhami ose vjen nga xhamia, Allahu, i përgatit në xhenet vendbanim (konak) sa herë që shkon dhe vjen.”* (Shënon Ibni Hibbani, Shuajb Arnauti   rëson sahih.)

Konaku është dhoma ku priten dhe gostiten mysafirët. Ky është një banket dhe unë po të ofroj skemën e këtij banketi:

1. Fillo përgatitjen për namaz dhjetë minuta para ezanit. Ti e ke të qartë se fillimi i vërtetë i namazit është abdesti. Muhamedi sallahu aljehi ve selem thotë: *“Kur robi i Allahut merr abdes dhe e lan gojën e tij, prej saj bien veprat e këqija. Kur ai e shpëlan hundën e tij, prej saj dalin mëkatet. Kur ai lan fytyrën, veprat e këqija bien prej saj, derisa dalin dhe nga nënvetullat e tij. Kur ai lan duart e tij, veprat e këqija bien prej tyre, derisa dalin nën thonjtë e tij. Kur ai e fërkon kokën, bien mëkatet nga koka e tij, derisa dalin edhe nga veshët. Kur ai lan këmbët e tij, veprat e këqija bien prej tyre, derisa dalin edhe nga thonjtë e këmbëve. Pastaj e ecura për në xhami dhe namazi i tij do të jenë shpërblim shtesë për të (mbi shpërblimin e abdesit).”* (Shënon Imam Ahmadi, Shuajb Arnauti   rëson shih.)
2. Ndieje gjatë marrjes së abdesit çdo fjalë të këtij hadithi. Shikoje ujin kur rrjedh prej gishtave, shikoje ujin kur pikat bien nga mjekra, kështu pastrohesh

nga gjynahet dhe e ndien veten në atë moment të pastër.

3. Dil për në namaz, por të lutem që këtë ta ndiesh, ta përjetosh. Të kërlesh kënaqësi sa herë që i lëviz këmbët dhe ta shohësh veten duke u ngritur në një shkallë dhe largim të një gabimi.
4. Futu në xhami para ezanit dhe qëndro për një moment duke përmbledhur njetet (qëllimet) e tua me zemër të gjallë. Largoje shejtanin, harroji hallet (shqetësimet), izolohu nga dynjaja.
5. Ndiqe ezanin me prezencën e zemrës. Allahu ekber, Allahu është më i madh se çdo hall i yti. Allahu ekber, Allahu është më i madh sesa angazhimet e tua. Allahu ekber, Allahu është më i madh se fatkeqësia jote. Allahu ekber, Allahu është më i madh se mëkatet e tua. Allahu ekber , Allahu është më i madh se çdo gjë.
6. Bëj salavate mbi të dashurin tënd, Muhamedin salallahu alejhi ve selem, sa të mundesh. Lutju Allahut për ndërmjetësim. Më pas fal sunetet para farzit me qetësi, me prezencën e zemrës dhe përqendrim të madh.
7. Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Duaaja mes ezanit dhe ikametit nuk refuzohet.”* (Shënon Imam Ahmadi, Albani *vol. 1* shih.) Ngriji duart me përulësi, modesti, i nënshtruar. Lutju Allahut, çelësat e mirësisë janë në duart e Tij, që të ta hapë një derë të mëshirës së Tij. Angazhohu në dua, bëj sikur qan, sepse fëmija, kur kërkon diçka, nëse nuk i jepet qan.

8. Përpiqu të falesh pas imamit apo pranë tij, në mënyrë që të ndikohet zemra gjatë leximit të Kuranit. Angazhohu që të mos humbasësh asgjë nga namazi.
9. Ndieje se gjatë namazit je para Allahut të Lartësuar, sunduesit të mbretërve. Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Kur të falni namaz, mos lëvizni (përqendrohuni), ngase Allahu i Lartësuar vazhdon të qëndrojë përballë robit të Tij derisa të mos shpërqendrohet (nga namazi).”* (Shënon Imam Ahmadi, Albani *✓✓✓*son shih.) Kjo vlen gjatë qëndrimit në këmbë.
10. Ndieje rukunë, madhërimin e Zotit, përulësinë e Tij. Sexhdja është një kënaqësi e veçantë, së cilës asgjë nuk mund t'i afrohet. Allahu i Lartësuar thotë: *“Bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!”* (Al~~██~~, 19). Ndieje afërsinë dhe nënshtrimin, se kështu do të lartësohesh, sepse sa herë që bën një sexhde për Allahun, Ai të ngre një shkallë.
11. Lutju shumë Allahut në sexhde, edhe pas teshehudit edhe para selamit. Këto janë vende që lutja pranohet, sidomos kur i lutesh Allahut me emrin e Tij të madh. Ai përgjigjet dhe kur i kërkon, ta jep. Muhamedi salallahu alejhi ve selem hyri në xhami dhe pa një njeri që lutej pas namazit me lutjen *“Allahume eseluke ja Allah el-ehad es-samed, el-ledhi lem jelid, ve lem juled, ve lem jekun lehu kufuven ehad. en tegfire li dhunubi. in-neke entel gafurur-rehim”*. (O Allah, unë të dr~~██~~tohem Ty O Allah, s~~██~~Ti j~~██~~Një dh~~██~~i V~~██~~ëm, Ty ta kanë n~~██~~vojën të gjitha krij~~██~~sat dh~~██~~të gjitha Ty të dr~~██~~tohem, i Cili as nuk lind dh~~██~~as nuk është i lindur, dh~~██~~s'ka asnjë të barabartë apo të krahasu~~██~~shëm m~~██~~

Të; të m'i falësh gabim-t (mëkat-t) mëmia, më të vërtetë Ti j-Falësi, Mëshiruesi.) Muhamedi salallahu alejhi ve selem tha: “Ai e fali atë. E fali atë. E fali atë.” (Shënon Ebu Davudi, Albani vol-ësor sahih.)

- 12.** Pas selamit qëndro mirë, duke e ruajtur energjinë e namazit, duke e ndier arritjen e kënaqësisë së syrit pas leximit të Kuranit, dhikrit, duasë, rukusë, sexhdes. Pastaj fillo me duatë (edhkar) e ligjshme dhe të gjitha kryeji me qetësi.
- 13.** Pastaj fale sunetin pas farzit, duke i përmbledhur ndjenjat e abdestit, shkuarjes në xhami, ndjekjes së ezanit.
- 14.** Këshillë: Lexo edhe një herë pikat e lartpërmendura që të përjetosh atë që të ka përgatitur Allahu në xhenet. Vendbanimi, konaku i Allahut të Lartësuar është nder nga Ai. Atëherë urdhëro e merr nga frytet e shumta dhe të bëfshin mirë!
 - Kujto hadithet që flasin për vlerën e abdestit në faljen e gjynaheve;
 - Kujto vlerën e duasë pas abdestit, kur hapen tetë dyert e xhenetit dhe ke mundësinë e hyrjes nga cila dëshiron;
 - Shkuarja në xhami ka shpërblime të shumta, si fshirje të mëkateve, ngritje të shkallëve, etj.;
 - Shpërblimi i ezanit përfundon me shefat (ndërmjetësim);
 - Shpërblimi i pritjes së namazit ka sevapin e namazit dhe duatë e melaikeve.

- Pastaj është sevapi i tekbirit fillestar, i namazit me xhemat, i safit të parë, i anës së djathtë të safit;
- Sevapet e dhikrit, suneteve.

Për Allahun, ju betohem: A nuk është ky një banket?!

Për Allahun, më tregoni kush mund ta humbë këtë gosti, nëse ka mundësi të marrë pjesë?!

3. Projekti i dhikrit

Allahu i Lartësuar thotë:

“O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje! Është Ai që ju bekon, ndërkohë që engjëjt e Tij luten për ju, me qëllim që Ai t’ju nxjerrë nga errësira në dritë. Ai është Mëshirues ndaj besimtarëve.” (Ahزاب: 41-43)

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Nuk ka ditë që vepra të jetë më madhështore dhe më e dashur tek Allahu sesa këto dhjetë ditë, prandaj shqiptoni sa më shumë tehlil (La ilahe il-lAllah), tekbir (Allahu ekber) dhe tahmid (El-hamdu lil-lah).” (Shënon Imam Ahmadi, Shuaib Arnauti rreth kësaj hadithi sahih.)*

Duhet ta kemi të qartë se dhikri, përkujtimi i Allahut, është më i madh se çdo gjë.

Merre me mend, përkujtimi i Allahut është më i madh se namazi! Allahu i Lartësuar thotë:

“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.” (Ankebut: 45)

Imagjino, përkujtimi i Allahut është më i madh se zekati! Ebu Derdaja thotë: “Isha tek i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem, kur disa prej njerëzve i thanë: “O i Dërguar i Allahut, të pasurit na e kaluan me të mira: ata falen sikurse ne, agjërojnë sikurse ne, japin sadaka (ndihmojnë), por ne nuk kemi me çfarë të ndihmojmë. Ata japin në rrugën e Allahut, por ne nuk kemi ç’të

japim.” I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem tha:
*“A doni t’ju tregoj diçka që, nëse e punoni, nuk ka kush
 jua kalon (me shpërblime) dhe nuk ka kush ju arrin, me
 përjashtim të atij që vepron njësoj si ju? Atëherë pas çdo
 namazi thoni subhanallah tridhjetë e tri herë, elhamdu
 lilah tridhjetë e tri herë dhe Allahu ekber tridhjetë e tri
 herë.”* (Mutafkun alejhi, Buhariu dhe Muslimi.)

Mendo, përkujtimi i Allahut të Lartësuar është më
 i madh se xihadi në rrugën e Allahut! Ebu Dardaja
 thotë: “Ka thënë i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve
 selem: *“A doni t’ju tregoj për veprën tuaj më të mirë, më
 fisnike, më të ngritur te Sunduesi juaj, gjithashtu më e
 mirë për ju sesa shpërndarja (dhënia) e arit dhe argjendit,
 po ashtu edhe më e mirë për ju se takimi me armikun dhe
 bërja e luftës?”* I thanë po. Tha: *“Dhikrullahi teala,
 përkujtimi i Allahut të Lartësuar.”* (Shënon Imam Ahmedi,
 Albani vol. 3 rreson sahih.)

Allahu i Lartësuar thotë: *“...përmendeni Allahun
 duke qëndruar në këmbë, ulur dhe të shtrirë.”* (Enisa: 103)

Natën e ditën, në tokë e det, në udhëtim e në
 shtëpi, në pasuri e varfëri, të sëmurë a të shëndetshëm,
 haptas e fshehtazi, pra në çdo gjendje. Fjalët më të mëdha
 në përgjithësi gjatë këtyre ditëve janë “Subhanallah,
 Elhamdu lilah, La ilahe il-lallah, Allah ekber”, fjalë të
 përjetshme. Kështu na informoi Muhamedi salallahu
 alejhi ve selem, se çdo fjalë mbjell nga një pemë në
 xhenet dhe shpërblimi i çdo fjale tek Allahu është sa
 kodra e Uhudit.

Xhafer bin Sulejmani thotë: “E kam parë Thabit el-
 Benanin në tubimet e diturisë që ndalej nga fjalimi dhe
 shqiptonte Allahu ekber, Allahu ekber, La ilahe il-lallah,

Allahu ekber ve lil-lahil hamd. Dhe thoshte se këto janë ditët e dhikrit.”

Ti mund të bësh një pyetje: Kur t’i shqiptoj këto fjalë?

Të përgjigjem: Mësoje veten... mësoje veten... mësoje veten:

1. Duke ecur rrugës;
2. Në shtrat, kur bie të flesh;
3. Gjatë bisedës, duke ngrënë;
4. Duke shkuar më herët në xhami.

Nëse do edhe diçka më tepër, është edhe më mirë për ty:

Istigfar (kërkim falje) për vetveten.

I Dërguari i Allahut thotë: *“Kush dëshiron të kënaqet me regjistrin e vet, le ta shpreshtojë istigfarin.”* (Shënon Bëhkuu, Albani  *vol*  *rëson sahih.*)

Istigfar (kërkim falje) për besimtarët dhe besimtaret.

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Kush bën istigfar për besimtarët dhe besimtaret, Allahu ia shënon nga një të mirë për çdo besimtar dhe besimtare.”* (Shënon Imam Ahmadi, Shuajb Arnauti  *vol*  *rëson sahih.*)

Salavatet për Muhamedin salallahu alejhi ve selem.

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Kush bie një herë në salavat për mua, Allahu dhjetë herë bën dua për të.”* (Shënon Muslimi)

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Sa herë që një musliman bie në salavate për mua, bien në salavate melaiket për të dhe atëherë robi le të bjerë në salavate*

ose le t'i shpeshtojë ato.” (Shënon Imam Ahmadi, Albani vlëshon hasn.)

Salavati i melaikeve është istigfar, ndërsa salavati i Allahut të Lartësuar është mëshirë.

Nëse i përmbahesh asaj që u tha më lart dhe bën dhikër jo më pak se një mijë herë në ditë, kjo do të thotë 5000 fidanë të mbjellë në xhenet. Po të vazhdosh kështu me dhikër gjatë këtyre dhjetë ditëve, parafytyro se si do të jetë kopshti yt në xhenet!

Parafytyro 100 000 fidanë në xhenet që do t'i kesh në pronësi vetëm për dhjetë ditë!

Një rast shumë i volitshëm, që nuk duhet humbur.

4. Projekti i agjërimit

Prej udhëzimeve (Sunetit) të Muhamedit salallahu alejhi ve selem ishte që ta agjëronte ditën e nëntë (Arafatin) të Dhul-hixhes. Nga disa gra të Muhamedit salallahu alejhi ve selem mësojmë se: *“Muhamedi salallahu alejhi ve selem agjëronte ditën e nëntë të Dhul-hixhes, tri ditët e çdo muaji dhe çdo të hënë dhe të enjte.”* (Shënon Ebu Davudi, Albani *vol* *është* *sahih*.)

Imam Neveviu, Allahu e mëshiroftë, për agjërimin e dhjetë ditëve thotë se është mustehab shumë i preferuar.

Atëherë agjëroji të nënta ditët, që të gjitha. Mos e humb asnjërën. Edhe nëse dikush të thotë se hadithi është i dobët, ti shfrytëzo frytet e agjërimit vullnetar në përgjithësi.

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Kush agjëron një ditë për Allahun, fytyrën e tij Allahu e largon nga xhehenemi shtatëdhjetë vjet.”* (Mut *është* *al* *është* *sahih*, Buhariu *dh* *është* *Muslimi*.)

Nga mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij, në rast të pamundësisë për ta kryer haxhin, është se e bëri këtë të fundit shoqërues në shpërblime me atë që ka shkuar në haxh.

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Tre vetave nuk u refuzohen lutjet.”* Njëri prej tyre është *“agjëruesi.”* (Shënon Imam Ahm *është* *Albani* *vol* *është* *sahih*.)

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Kush e përfundon jetën me agjërimin e një dite, ka hyrë në xhenet.”* (Shënon Imam Ahm *është* *Albani* *vol* *është* *sahih*.)

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë:
*“Allahu dhe melaiket e Tij luten për ata që ngrihen në
syfyr.”* (Shënon Imam Ahmadi, Albani ~~sh~~reson sahih.)

Këto janë disa fryte të agjërimit vullnetar. Vlera e këtyre ditëve të rikujton kohën e muajit Ramazan. Sido që të jetë, ti je fitues.

5. Projekti i haxhit dhe umres

Muhamedi salallahu alejhi ve selem ka thënë:
“Kush e fal sabahun me xhemat dhe qëndron duke përmendur Allahun derisa të lindë dielli, për të ka shpërblime si një haxh dhe umre të plotë, të plotë, të plotë.” (Shënon Tirmidhiu, Albani rëson sahih.)

Në këtë qëndrim duhet:

- të lexohet Kurani;
- të lexohen edhkaret (lutjet e mëngjesit);
- të ripërtërihet teubeja (pendimi);
- të bëhet lutje në vetmi;
- të falen ata që të kanë bërë padrejtësi;
- të kërkohet falje prej Allahut të Lartësuar;
- të bëhen ibadete (adhurime) të tjera.

Nga mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij, në rast të pamundësisë për ta kryer haxhin, e bëri këtë të fundit shoqërues në shpërblime me atë që ka shkuar në haxh.

Këtu kemi disa punë që e kanë shpërblimin si haxhi dhe umreja, kuptohet në pamundësinë e kryerjes së tyre.

Së pari: Dhikri, lutjet pas çdo namazi.

Ebu Hurejra tregon: “Disa të varfër erdhën tek i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem dhe i thanë:

“O i Dërguar i Allahut! Të pasurit na e kaluan me të mira: ata falen sikurse ne, agjërojnë sikurse ne, ata japin sadaka (ndihmojnë), por ne nuk kemi me çfarë të ndihmojmë. Ata japin në rrugën e Allahut, por ne nuk kemi çfarë të japim.” I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem tha: *“A doni t’ju tregoj diçka që nëse e punoni, nuk ka kush jua kalon (me shpërblime) dhe nuk ka kush ju mbërrin, me përjashtim të atij që vepron njësoj si ju? Atëherë pas çdo namazi thoni subhanallah tridhjetë e tri herë; elhamdu lilah tridhjetë e tri herë dhe Allahu ekber tridhjetë e tri herë.”* (Mutafekun aljhi, Buhariu dhe Muslimi.)

Së dyti: *Namazi i jacisë dhe i sabahut me xhemat.*

Ukbeja bin Andul Gaffari ka thënë: “Namazi i jacisë me xhemat është si një haxh dhe namazi i sabahut me xhemat si një umre.”

Së treti: *Namazi i sabahut me xhemat dhe dhikri deri pas lindjes së diellit dhe falja e dy rekateve.*

Muhamedi salallahu alejhi ve selem ka thënë: *“Kush e fal sabahun me xhemat dhe qëndron duke përmendur Allahun derisa të lindë dielli, për të ka shpërblime si një haxhi dhe umre të plotë, të plotë të plotë.”* (Shënon Tirmidhiu, Albani *shënon sahih*.)

Së katërti: *Falja e namazit me xhemat dhe falja e namazit vullnetar.*

Muhamedi salallahu alejhi ve selem ka thënë:
“Kush shkon për t’i falur namazet obligative me xhemat është sikurse një haxhi dhe kush shkon për të falur namaz vullnetar është me vlerën e një umreje vullnetare.” (Sahihul Xhami, Albani ~~vol~~ rreson hasan.)

Së pesti: *Namazi në xhaminë Kuba.*

Muhamedi salallahu alejhi ve selem ka thënë:
“Kush lahet në shtëpinë e vet, më pas vjen në xhaminë Kuba dhe falet në të, ka shpërblimin e një umreje.”
(Shënon Imam Ahmadi, Albani ~~vol~~ rreson sahih.)

Së gjashti: *Falja e Fitër Bajramit dhe e Kurban Bajramit.*

Ibni Rexhebi thotë: “Muhabef bin Selimi ka thënë:
“Dalja në Fitër Bajram ka shpërblimin e një umreje dhe dalja në Kurban Bajram ka shpërblimin e një haxhi.”

6. Projekti “KANATIRUL-FIRDEVS” (pasuria e grumbulluar në sasi të mëdha)

Muhamedi salallahu alejhi ve selem ka thënë: *“Kush fal namaz vullnetar me dhjetë ajete, nuk regjistrohet për gafil (neglizhent), kush falet me njëqind ajete shënohet prej kanitinëve (adhuruesve të devotshëm e të denjë) dhe kush fal namaz vullnetar me një mijë ajete shënohet prej mukantirinëve (personi me pasuri të panumërt).”* (Shënon Ebu Davudi)

Projekti ka të bëjë me faljen vullnetare për çdo natë me një mijë ajete, për çdo natë fiton pasuri të mëdha dhe të panumërta në xhenet. Por nëse nuk mund të falësh namaz vullnetar me një mijë ajete, fal namaz me njëqind ajete që të listohesh te “kanitinët”.

Hasan el-Basriu ka thënë: “Namazin e natës e lënë vetëm ata që kanë bërë gjynahe.”

Seid bin Xhubejri, kur hynin dhjetë ditët, angazhohej shumë në adhurim dhe thoshte: “Mos i fikni dritat në këto dhjetë net.”

Të mirat e namazit të natës:

1. Falësi i namazit të natës ka në xhenet dhoma që anën e jashtme e sheh nga brenda, kurse anën e brendshme e sheh nga jashtë.
2. Falësi i namazit të natës është njëri prej atyre të treve me të cilët Allahu qesh. E, kur Allahu qesh me robin e Tij, ai rob nuk do të ketë llogari.

3. Namazi i natës është traditë e njerëzve të mirë. Muhamedi salallahu alejhi ve selem ka thënë për të: *“Është traditë e njerëzve të mirë para jush, afrim tek Allahu i Lartësuar, pengim nga mëkatet, shlyerje e gjynaheve dhe dëbon sëmundjen nga trupi.”* (Shënon Tirmidhiu, Albani *shënon sahih.*) Në këtë hadith ka pesë dobi të namazit të natës.
4. Allahu e ka fshehur shpërblimin për falësin e namazit të natës dhe thotë: *“Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”* (Sahid 17)
5. Namazi i natës në dynja e lehtëson qëndrimin në këmbë në Ditën e Gjykimit.
6. Nëse e bën nijet për namaz të natës dhe nuk mund të ngrihesh, të regjistrohet nijeti i bërë. Muhamedi salallahu alejhi ve selem ka thënë: *“Kur një njeri duke falur namazin e natës e mund gjumi, Allahu i Lartësuar ia shënon shpërblimin e namazit dhe gjumin sadaka.”* (Shënon Tirmidhiu, Albani *shënon sahih.*)

7. Projekti i vëllazërisë për Allahun

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Prej robërve të Allahut ka njerëz të tillë që nuk janë Pejgamberë e as shehidë, ndërsa Pejgamberët dhe shehidët këta i shikojnë me kënaqësi për pozitën që kanë ata tek Allahu i Lartësuar.”* I thanë: “O i Dërguar i Allahut, na trego kush janë këta.” Tha: *“Ata janë një popull që janë dashur për Allahun, nuk kanë qenë familjarë mes vete e as që i ka lidhur pasuria. Por, pasha Allahun, vërtet fytyrat e tyre janë me nur (dritë) dhe ata janë në dritë, ata nuk frikësohen kur frikësohen njerëzit dhe nuk pikëllohen kur mërzhiten njerëzit”,* dhe lexoi ajetin: *“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.”* (Junus, 62)

Po të propozoj që së paku një herë në këto dhjetë ditë t’i ftosh shokët e tu për iftar. Para akshamit bëni vetëm gjysmë ore dhikër e dua, kurse pas iftarit edhe një gjysmë ore dhe dëgjoni Kuran. Më pas dhuroju ndonjë libër ose CD, që të fitosh:

1. Sevapin e agjëruesit;
2. Sevapin e davetit në rrugën e Allahut;
3. Sevapin e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja;
4. Sevapin e ndihmës për të mirë.

8. Projekti i lidhjes familjare

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“O njerëz! Jepni selam (përsëndetuni), jepni ushqim, mbani lidhjet farefisnore, falni namaz natën kur njerëzit janë në gjumë, do të hyni në xhenet me selame.”* (Shënon Imam Ahmadi, Albani ~~vol~~ëson sahih.)

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Farefisnia mbetet e varur tek Arshi dhe thotë: “Kush e vazhdon lidhjen me mua, ai ka vazhduar lidhjen me Allahun. E, kush ndërpret lidhjen me mua, ai ka ndërprerë lidhjen me Allahun.”* (Shënon Muslimi)

Atëherë kujdesu që së paku një orë në ditë ta ndash për:

1. T'u sjellë mirës ndaj prindërve;
2. Të vizituar ndonjë të afërm;
3. Të respektuar fqinjët;
4. Të gëzuar muslimanët.

9. Projekti i ditës së Arafatit

Vlerat e ditës së Arafatit:

1. Në këtë ditë është plotësuar feja.
Kjo shpjegohet në disa aspekte:
 - Muslimanët nuk e kryenin më parë haxhin, derisa ai u bë detyrim dhe kështu u kompletuan shtyllat e Islamit.
 - Allahu i Lartësuar e ktheu në rregullat e Ibrahimit, e mohoi shirkun dhe idhujtarët nuk u përzien më me muslimanët, u rrënuan shenjat e injorancës dhe u ndalua tavafi rreth Qabes lakuriq.
 - Pas kësaj dite nuk pati më dispozita mbi hallallin dhe haramin.
2. Në këtë ditë u plotësua dhuntia e Allahut duke realizuar faljen.
3. Është festë për pasuesit e Islamit.
4. Është ditë çift. Allahu i Lartësuar thotë: *“Beto hem për çiftin dhe tekun.”* (Fakher: 3), kurse tekun është dita e Bajramit.
5. Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Nuk ka ditë më shumë që Allahu liron njerëz nga zjarri sesa në ditën e Arafatit. Ai afrohet dhe pastaj mburret me ta para melaikeve duke u thënë: “Çfarë dëshirojnë këta?”* (Shënon Muslimi)
6. Arafati është ndër ditët më të vlefshme. Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Dita e Arafatit është njëra ndër ditët më të vlefshme.”* (Shënon Ebu Davudi, Albani *shpjegon sahih.*)

7. Është dita e haxhit.
8. Është dita e faljes së mëkateve. Transmetohet në formën mevkuf nga Ibni Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili ka thënë: “Muhamedi salallahu alejhi ve selem ka thënë: *“Nuk mbetet askush në ditën e Arafatit që ka sado pak iman e të mos jetë falur.”* Një njeri i tha: “O i Dërguar i Allahut! Ata që janë në Arafat apo njerëzit në përgjithësi?” Tha: *“Të gjithë njerëzit në përgjithësi.”* (Shënon Abd bin Hamid në “Musnadin” tij, 842.)
9. Aliu, biri i Ebu Talibit, thotë: “Nuk ka ditë në tokë që Allahu nuk liron nga zjarri. Kurse dita që lirohen më së shumti është dita e Arafatit. Atëherë shpreshtoni lutjen: “O Allah, liroje qafën time nga zjarri.”
10. Agjërimi i ditës së Arafatit shlyen mëkatet e dy viteve. Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Për agjërimin e ditës së Arafatit shpresoj se Allahu fal mëkatet e vitit të kaluar dhe të vitit të ardhshëm.”* (Shënon Muslimi)

Vëlla i dashur!

A e ke kuptuar vlerën e kësaj dite?

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Për agjërimin e ditës së Arafatit shpresoj se Allahu fal mëkatet e vitit të kaluar dhe të vitit të ardhshëm.”* (Shënon Muslimi)

Atëherë së bashku le të bëjmë një llogari: agjërim 12 orë baras me 24 muaj falje.

Agjërim 12 orë = Falje 24 muaj

Le të bëjmë edhe një llogari:

1 orë agjërim = 2-muaj falje

Domethënë për çdo 60 minuta agjërim, 60 ditë falje.

A është ndonjë i mençur që dëshiron ta humbasë minutën? Pa dyshim që jo.

10. Projekti i ditës së Bajramit

Kujdes, shumë kujdes, pasi sezoni i mirësive nuk ka përfunduar. Kjo ditë është dita e dhjetë e Dhul-hixhes. Vlera e veprave të mira vazhdon. Mos e humb kohën në këtë ditë me gjëra të padobishme.

Bajramin mos e llogarit si festë duke bërë mëkat. Kujto urtësitë e Bajramit, si një ditë falënderimi, përkujtimi, bamirësie. Kujdes që të mos të biesh në gjëra të ndaluara (haramë), si muzika, përzierja e gjinive etj., që të mos jenë shkak për degradimin e veprave të mira që ke vepruar gjatë dhjetë ditëve.

Mëso se dita më me vlerë e vitit është dita e Bajramit. Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Dita më e vlefshme tek Allahu është dita e Bajramit, pastaj dita që vjen pas saj.”*

Plani i kësaj dite:

1. Fillo me namazin e Bajramit, duke qenë i gëzuar dhe i qeshur para muslimanëve.
2. Mbaj lidhjet me farefisën, prindërit, të afërmit, shokët.
3. Ther kurban.

1. Çdo ditë ti ndërton nga një shtëpi në xhenet nëse fal vetëm 12 rekate sunete. Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: *“Nëse një rob musliman i fal për Allahun çdo ditë nga 12 rekate vullnetare, që nuk janë detyrim (farz), Allahu ia ndërton një shtëpi në xhenet.”* (Shënon Muslimi) Llogarit pak: për 10 ditë, dhjetë shtëpi në xhenet.
2. Çdo ditë ti ndërton nga një pallat në xhenet. Lexo suren Ihlas (Kulhuvallahu ehad...) 10 herë në ditë dhe çdo ditë Allahu ta ndërton një pallat në xhenet. Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: “Kush lexon “Kulhuvallahu ehad” dhjetë herë, i ndërtohet një pallat në xhenet.” (Shënon Daremiu, 3429, është mursel.)
3. Mos harro t’i gëzosh familjet e varfra duke i vizituar para Bajramit dhe duke u dhuruar para, ushqime e rroba.
4. Mundohu ta praktikosh premtimin e Muhamedit salallahu alejhi ve selem që brenda ditës të realizohen agjërimi, përcjellja e xhenazes, vizita e të sëmurit, sadakaja, se të hapen të gjitha dyert e xhenetit.

Hyrje	2
Vlera e dhjetëditëshit të Dhul-hixhes	4
1 - Projekti i Kuranit	10
2 - Projekti i banketit për çdo namaz	12
3 - Projekti i “dhikrit”	17
4 - Projekti i agjërimit	21
5 - Projekti i haxhit dhe umres	23
6 - Projekti “KANATIRUL-FIRDEVS”	26
7 - Projekti i vëllazërisë për Allahun	28
8 - Projekti i lidhjes familjare	29
9 - Projekti i ditës së Arafatit	30
10 - Projekti i ditës së Bajramit	32
11. Shanset e arta	33